



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash

- Kuvendi Komunal

01 Nr.020-588/2-09/ 320-450

Dt. 03.11. 2010

D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.02.11.2010, duke shqyrtuar kërkesën 09 Nr.320-450 të z.Sherif Kryeziu nga Breznja adresuar Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK-së Dragash, të drejtuar Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së lidhur me ndryshimin e destinimit të tokës, nga ajo bujqësore në ndërtimore (ndërtimi i objektit për përpunimin e mishit), miraton këtë :

V E N D I M

- I. NJOFTOHEN parashtruesi i kërkesës dhe Drejtorati se OBLIGOHEN që të kanë parasysh faktin se ai lokalitet është shpallur me interes të posaçëm shoqëror, nga se parashihet ndërtimi i HC “Zhur” për çka, kohë më parë, me Vendimin 02 Nr.351-129 të dt.30.06.2009, kryetari KK-së ka njoftuar banorët e këtij lokaliteti, për ndalesën e ndërtimeve.
- II. AUTORIZOHET Drejtorati Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të KK-së që për këtë të njofton palën, përmes Aktvendimit përkatës, për refuzim të kërkesës.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

A r s y e t i m

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.02.11.2010, pas Informatës me arsyetimet e dhëna nga drejtori i Drejtoratit për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së, vendosi në s'ë pikën I të këtij Vendimi, duke autorizuar Drejtoratin që të zbaton procedurat e nevojshme ligjore, me lëshimin e Aktvendimit përkatës për parashtruesin e kërkesës.

Shtojcë: Vendimi kryetarit të KK-së Dragash 02 Nr..351-129

I dërgohet :

- Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së, drejtorit Bean Haxhihasan,
- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK-së, drejtorit Bajram Hoxha,
- Parashtruesit të kërkesës z.Sherif Kryeziu, Brezne, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH

Kryesuesi

Lulzim Kërsaj

